

## **SUBJEKTI MINERAR "SHEBENUKU-G" SH.P.K**

Adresa: Impianti i perpunimit te kuarcit Lunik, fshati Lunik,bashkia Librazhd.

### **PËRMBLEDHJE E SHKURTUAR**



**NË GJUHË JO TEKNIKE TË PËR TU  
PAJISUR ME LEJE MJEDISORE TIPI-B  
ZONA MINERARE NR-165**

## **1-Konsiderata te per gjitheshme.**

a-Te dhena mbi subjektin qe aplikon per zgjatje leje minerare.

### **i- SUBJEKTI MINERAR "Shebeniku-G" sh.p.k. LIBRAZHD.**

ii-Lejet minerare ka pasur nje leje shfrytezimi per mineralin e kromit ne zonen e Shebenikut, leja Nr-266, dt 23/04/1996. Kjo leje ka mbaruar me dt 23/04/2016 dhe nuk eshte zgjatur , pasi zona u shpall park kombetar.

Duke qene se :

- ❖ 1-Subjekti « **Shebeniku-G**» ka nje eksperience mbi 20 vjecare ne kerkimin dhe shfrytezimin e mineraleteve nentoke dhe siperfaqe ( zoterus i lejes se shfrytezimit Nr-266 , dt 23/04/1999) .
- ❖ Zoteron te gjitha paisjet dhe makinerite e domosdoshme per shfrytezimin e mineralit te kromit nentoke dhe siperfaqe.
- ❖ Ka kryer punime kerkim-zbulimi per mineralin e kromit ne zonen ku kerkohet leja mjedisore, pajisur me leje mjedisore me numer **PN-2259-09-2011** ( bashkengjitur ne fund te tekstit) duke mare nje informacion te mjaftushem mni mineralin e kromit , ne saj te investimeve te kryera nga viti 2012-2014
- ❖ I lind e drejta per tu pajisur me leje mjedisi per shfrytezimin e mineralit te kromit.

iii- Lloji i Mineralit per te cilen kerkohet zgjatja e lejes : **Mineral Kromi**

iv- Emri dhe mbiemri i Administratorit: Inxh. **Dashamir GEGA**

v- Adresa e selise se subjektit:Impianti i perpunimit te kuarcit, Lunik, njesia administrative Lunik, bashkia Librazhd.

vi -Nr. Telefonit/ faksit ; 0682555002, E-Mail :dashamirg61@gmail.com

vii- Emertimi i njesise Vendore: Fshati Lunik, Njesia Administrative **Lunik** ,

### **Bashkia LIBRAZHD**

viii- Emri dhe Mbiemri i drejtusit teknik: Dashamir GEGA

ix- Diploma : **Nr.8-1684 date 15 Janar 1986**, afati i perfundimit- Pa afat

## **2-Baza ligjore dhe argumentuse mbi të cilën subjekti kërkon per tu pajisur me leje mjedisore të tipit B.**

Baza ligjore ku mbeshtet investimi i parashikuar, ne menyre te shkurtuar permblidhet:

**A**-Subjekti eshte zoterus i lejes se mjedisore per aktivitet kerkim-zbulimin e mineralit te kromit ne zonen e fushes se madhe me Nr. **PN-2259-09-2011**. Ne kuader te informacionit te marre, nga kryerja e punimeve minerare ,subjekti per tu pajisur me leje shfrytezimi kerkon leje mjedisor per shfrytezim, leje e Tipit B.

**B**-Subjekti ka perfunduar te gjitha investimet paraprake per shfrytezimin e mineralit te kromit , ne kuader te lejes se kerkim-zbulimit dhe me marjen e lejes se shfrytezimit do te filloj aktivitetin perkates.

### **1.2. Vendndodhja e objektit**

Objekti i kerkuar per licensim ndodhet ne ndarjen administrative ; Rrajce, bashkia Prrenjas.

Objekti i kromit “Fusha e madhe ” ndodhet ne afersi te fshatit Katjel dhe rodokal, eshte pjeserisht i studjuar nga sherbimi gjeologjik, por per natyren e trupave ( te vegjel) zbulimi me efikas, do te ishte zbulim dhe shfrytezim i tij. Ne afersi te objektit ndodhet minjera e Fe-Ni Katjel dhe ajo e Rodokalit.

Ben pjese ne zonen Lindore malore, ne lartesine mesatare + 1000 m mbi nivelin e detit. Qendra me e banuar me e afert eshte fshati katjel , qe ndodhet, ne vije ajrore rreth 1.2 km me ne veriperendim te objektit.

Objekti lidhet me rrugen automobilistike “Qaf Thane-Cervenake” si dhe degeziminacionale Prenjas minjera e kromit Katjel. Objekti ndodhet larg nga ish miniera e Katjelit, rreth 2.5 km, ne jug lindje te saj. Ne kete zone nuk ka linje elektrike.


Objekti ndodhet ne harten ne shkalle 1 : 25 000 me nomenklature K – 34 - 102 – C - c. (Perrenjas).

Siperfaqja e kerkuar per leje minerare kufizohet nga pikat me koordinata e dhena ne tabelen e meposhteme :

| Nr. i pikes | Koordinatat |         |
|-------------|-------------|---------|
|             | X           | Y       |
| 1           | 4543100     | 4465300 |
| 2           | 4543200     | 4466600 |
| 3           | 4542600     | 4465800 |

Zona e mesiperme ka siperfaqe ose **0.35 km<sup>2</sup>**.

Harta topografike në shkalle 1:25000 e zonës minerare Nr. 165





## **Gjegrafia e zones**

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti qe kerkohet per shfrytezim, duke qene se ben pjese ne zonen kodrionore malore te lindje se vendit tone, eshte terren kodrinoro-malor, i nderthurur ndermjet pjeses fushore-kodrinore dhe asaj malore, lartesite e te cilave jane rrreth 1000 m mbi nivelin e detit.

Objekti ndodhet ne relief kodrinor-malor me pranine e disa prroskave malore ne veri dhe jug te tij. Kuota me e ulet eshte e perroi i Katjelit ( $H=517\text{ml}$  dhe me e larta maja e Larte (maja e Cervenakes) me kuote  $1400\text{ml}$ ). Per nga pozicioni gjeografik zona ndodhet ne jug te Shebenikut, ne pjesen qendrore te tij. Formacinet shkembore ultramafike kane kushtuar relievin e kesaj zone mjaft te thepisur, por vende-vende kemi dhe zona me relief jo shume te thepisur ku zhvillohet nje bimesi e paket (bushi).

Siperfaqjq e objektit nuk eshte e mbuluar me pyll, nuk eshte toke buqesore, mbi te nuk ka vepra arti , argjinatura dhe vepra hidroenergjetike.

## **Popullsia , klima , infrastruktura e zones.**

**Popullsia** - Zona perreth (objektit) eshte pak e banuar. Lagja me e afert eshte Lagja Mucaj e Fshati i Katjel qe ndodhet  $3.2\text{ km}$  ne jugperendim te objektit. Ne afersi te zones dhe rrotull saj nuk ndodhet asnje objekt qe te perbeje rrezik gjate punimeve te shfrytezimit. Popullsia per rrreth, lagja e Mucajve nuk i kalon  $1000$  banore. Nje pjesa e mire e tyre, per nje periudhe mbi  $50$  vjecare, kane punuar ne shfrytezimin e Fe-Ni dhe kromit ne minjeren e Katjelit, Hekur –Nikelit te katjelit dhe Radokalit. Pjesa tjeter eshte mare me blegtori dhe me pak me bujqesi.

Ne zone ekziston nje experience per shfrytezimin e mineraleve. Sot nje pjesa e mire e ketyre banoreve kane emigruar ne Greqi per mungese vende pune.

Ne pikepamjen klimaterike zona e "Fusha e madhe " bene pjesa ne nenzonan qendrore te zones klimatike malore. Dimri, per gjithesisht, eshte i ashper dhe me lageshti, kurse vera eshte e nxehte dhe e thate. Kjo zone ka mbi  $2500$  ore ndriçim dielli ne vit. Muaji me ndriçim me te gjate eshte Korriku me  $350$  ore, kurse me ndriçimin me te shkurter eshte Dhjetori, me  $108$  ore.

Tempeeratura mesatare vjetore e ajrit eshte afersisht  $13.8$  grade celcius. Muaji me temperaturen mesatare me te larte eshte Gushti me  $37^0$  grade celcius, kurse ai me temperaturen me te ulet eshte Janari me  $-5^0$  celcius. Ne per gjithesi, ndryshimet mujore te temperatures jane graduale. Keto ndryshime jane me te medha kur kemi te bajme me ndryshimin e regjimit te stineve. Ky fenomen ndodh ne periudhat Mars – Prill dhe Tetor – Nentor, kur kemi perkatesisht kalimin nga rregjimi dimeror ne ate pranveror dhe nga rregjimi vjeshtor ne ate dimeror.

Vlera maksimale e temperatures se ajrit ne kete zone, me koeficient sigurie  $50\%$ , eshte rrreth  $37$  grade celcius. Vlera e temperatures me te ulet minimale ( $-10$  grade celcius), te rregjistruar ne kete zone, i perket dates  $14$  janar  $1985$ . Mesatarja e sasise se reshjeve vjetore eshte rrreth  $1600 \text{ mm/vit}$ . Sasia e reshjeve vjetore

eshte shperndare ne menyre te çrregullt ne kohe. Keshtu, ne periudhen Tetor-Maj, rregjistrohen rreth 70 % e sasise se reshjeve vjetore. Muaji me i laget i vitit eshte Nentori me 223 mm reshje, ndersa muaji Korrik eshte me i thati me rreth 59 mm.

Drejtimet kryesore te ererave dominuese ne kete zone jane V-J dhe VP-JL.

**Infrastruktura :** Ne pergjithesi rajoni, rrathi dhe zona ku ndodhet objekti per specifikat morfollogjike dhe urbane lidhen me rruge makine qe shkon ne sektorin e minjere e Cervenakessi dhe ate te kromit Gjorduke-Fusha e madhe. Subjekti nuk do te hapi rruge auto pasi jane te hapura, me perjashtim te rrugeve te brendeshme te shfrytezimit.

Rruja ekzistuese eshte e kategorise se trete e pa asfaltuar deri tek rruga nationale Qaf Thane –Cervenake. Hapja e ketij aktiviteti do te bente te mundur rregullimin e infrastruktures e cila do ti sherbente me mire interesave ekonomike te ketij komuniteti.

### **Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore te saj**

Ne rrethin e Librazhdit historikisht dhe tradicionalisht, e cila vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim blegtoria dhe me pak bujqesia.

Ne periudhen 1955-2000 nje pjese e mire e burrave te kesaj zone punuan ne minjerat e hekur nikelit dhe ato te kromit (minjera e Gjorduke-Fusha e madhe , duke e kthyer specialitetin e minatorit ne nje tradite. Pas viteve 1998 te gjitha minjerat u mbyllen duke krijuar mjaft papunesi dhe emigrimi. Burimi kryesor ekonomik i kesaj zone ne ditet e sotme ngelet emigrimi dhe me pak blegtoria. Bujqesia ze vend shume te ulet per mungese se tokes se bukes si dhe reliivi teper malor qe nuk e favorizon.

Duhet theksuar se pjesa e afte per pune ne moshe te re jane larguar prej shume vitesh ne emigracion jasht shtetit. Duke qene se banoret e kesaj zone cdo dite jane duke u larguar dhe braktisur ate per mungese te punes, hapja e nje aktiviteti te tille do te bente te mundur te hapeshin vende te reja pune dhe do te zbuteste sado pak largimin e popullsise.



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

LEJE

|  |                             |   |
|--|-----------------------------|---|
| PN-2259-09-2011  | NUIS/NIPT: K98220601B       | Emërtimi përshkrues i veprimtarisë<br><br>Leje mjedisore kërkim-zbulimi për mineralin Krom.                                 |
| "SHEBENIKU-G"  |                             |   |
| Adresa Elbasan LIBRAZHD Lunik Adresa: Lunik Lagjja Lugjet, Rruga Lunik-Librazhd, Impianti i Përpunimit Kuartcit. |                             |   |
| Kodi III.1.B   | Kodi tjeter                 |   |
| Data e lëshimit 2011-09-26   | Afat i vlefshmërisë Pa afat | Kufizime specifike<br><br>Leja ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi   |
| Kategoria<br><br>Për ndikimin në mjedis  |                             | Detyrime specifike<br><br>Leja ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi   |
| Nënkategori<br><br>Leje mjedisore  |                             |   |
| Veprimtari specifike   |                             | Vendi i kryerjes së veprimtarisë<br><br>Qarku: Elbasan Rrethi: LIBRAZHD B/K: RRAJCE Q/F: Adresa: Zona Katjel-Fusha e Madhe. |
| Specialiteti   |                             | Nënshkrimi i sportelit _____  |



Vulosur elektronikisht nga Qendra  
Kombëtare e Biznesit  
Date:2020/10/01 17:44:19 +0200  
K98220601B20201001174333624006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedurë automatiske nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)